



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË KLINËS

Klinë, maj 2016

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c) dhe nenit 17, pika s) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.28/15, qershor 2008), nenit 10, pika 3 të Statutit të Komunës së Klinës, 01. nr.110-1232/2010, si dhe duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Arsimit, si dhe në dispozitat e 6 të rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transferove, nr.06-4043/2015, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen e mbajtur, më dt.27/05/2016, miratoi këtë

R R E G U L L O R E P Ë R N D A R J E N E B U R S A V E P Ë R S T U D E N T Ë T Ë K O M U N Ë S S Ë K L I N Ë S

I. D I S P O Z I T A T E P Ë R G J I T H S H M E

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, dhe procedura për ndarjen e bursave për studentë/e të Komunës së Klinës, të cilët studiojnë në universitete publike të Republikës së Kosovës.

Neni 2

Kuvendi i Komunës, me propozim të kryetarit merr vendim për numrin e bursave, lartësinë e bursave, periudhën kohore dhe vitin akademik, varësisht nga mjetet financiare që ka në dispozicion.

Neni 3

1. Bursat për studentë/e do të ndahen nga komisioni, i formuar me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës së Klinës.

Komisioni do të jetë i përbërë nga 5 anëtarë, sipas formulës:

1.1. dy (2) nga Kuvendi;

1.2. dy (2) nga ekzekutivi dhe;

1.3. një (1) nga shoqëria civile.

Neni 4

1. Drejtoria e Arsimit do të shpallë konkursin publik për ndarjen e bursave duke përfshirë degën dhe numrin e bursave. Konkursi duhet të jetë i shpallur në mjetet e informimit, përkatësisht në gazetë ditore, në Web-faqen e Komunës, në tabelën e shpalljeve, dhe do të qëndrojë i shpallur për 15 ditë.

2. Në konkurs do të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat e tjera të nevojshme.

Neni 5

Drejtoria e Arsimit obligohet që t'i kryejë punët e domosdoshme tekniko-administrative që rrjedhin nga natyra e punës së komisionit, si dhe punët rreth shpalljes së konkursit, pranimit të kërkesave, formulimit të kontratave e të ngjashme.

II. KUSHTET DHE KRITERET E APLIKIMIT

Neni 6

Për fitimin e bursave kanë të drejtë të konkurrojnë kandidatët /et që i plotësojnë kushtet si në vijim:

1.1. Të jenë studentë/e të cilët studiojnë në universitete publike të Republikës së Kosovës, por jo edhe ata me vetëfinancim, korrespondence, studentë në studime pasuniversitare– master dhe doktoratë;

1.1. Të jenë studentë/e të rregullt, të vitit të 2-të e më lart;

1.2. Të jenë banorë të përhershëm të Komunës së Klinës;

1.3. Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;

1.4. Të jenë studentë që nuk janë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër nga buxheti i Kosovës si dhe të mos jenë të punësuar ne institucione publike;

1.5. Studentë që kanë të kryera të gjitha provimet e vitit paraprak;

1.6. Studentë që nuk janë përsëritës të vitit;

1.7. Studentë që kanë notën mesatare 7.5 e më të lartë, përveç studentëve të profileve deficitare, si në piken 1.8 të këtij neni;

1.8. Përparësi në fitimin e së drejtës në bursë do të kenë studentët që studiojnë në lëmenjtë deficitare (Fakulteti i Mjekësisë-drejtimi i përgjithshëm, Fakulteti Teknik- drejtimi Elektro, Arkitekturë dhe Ndërtimtari, FSHMN-drejtimi Matematikë-profilu arsimor dhe Drejtimi Fizikë-profilu arsimor);

1.9. Renditje e profesioneve brenda profileve deficitare caktohet në konkurs nga ana e Drejtorisë së Arsimit, sipas nevojave të tregut të punës.

III. KRITERET DHE PËRPARËSITË E PËRFITIMIT TË BURSËS

Neni 7

1. Për suksesin e arritur në mësim në vitin paraprak, kandidati/ja vlerësohet me pikë si në vijim:

1.4. Poentimi vlerësohet me po aq pike sa është nota mesatare e studentit.

2. Përparësi në start kanë profilet deficitare si nga pika 1.8 e nenit 6 të cilët poentohen qe ne start me 5 pikë bonus;

3. Studenti/ja që studiojnë së bashku me një anëtar/e nga e njëjta familje, vlerësohet 2 pikë;

4. Studenti/ja me aftësi të kufizuar vlerësohet me 2 pikë;

5. Studenti/ja, i cili nuk i ka dy prindërit në jetë, vlerësohen me 1 pikë.

Neni 8

Sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta të cekura në nenin 7, do të kenë përparësi:

1). Studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës;

2). Studentët me aftësi të kufizuar;

3). Studentet e gjinisë femërore.

Neni 9

1. Nëse përfituesi i bursës ndërron fakultetin, humb të drejtën e shfrytëzimit të bursës;

2. Nëse vërtetohet se student i është përfitues i bursës nga komuna, është duke marrë bursë edhe nga ndonjë njësi tjetër buxhetore, ai/ajo obligohet ta kthejë bursën.

IV. VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE

Neni 10

Pas skadimit të afatit të konkurrimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e kërkesave. Gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave, komisioni do të përcaktojë metodën e punës dhe mënyrën e seleksionimit të kërkesave, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 11

1. Pas përfundimit të procedurës së seleksionimit, komisioni do të hartojë listën e përgjithshme të kandidatëve përfitues të bursës.
2. Lista e përfituesve do të shpallet publikisht dhe do të vendoset në Web- faqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

Neni 12

1. Kundër vendimit për shpalljen e listës së përfituesve të bursave nga komisioni për ndarjen e bursave, lejohet ankesa, e cila i drejtohet komisionit të ankesave, i formuar “ad hoc” me vendim të Kuvendit të Komunës. Ankesa ushtrohet në afat prej 7 ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga ana e komisionit.
2. Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesën e ushtruar.

Neni 13

1. Me përfituesit e bursave do të lidhet kontrata, e cila do të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i bursës.
2. Nëse nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e njoftimit të kandidatit përfitues i bursës, do të konsiderohet se ai ka hequr dorë nga bursa dhe përfitues do të jetë kandidati që është në listë sipas radhës.
3. Kohëzgjatja për dhënien e bursës është 1 vjeçare duke përfshirë periudhën 1 tetor 30 shtator, përkatësisht vitin akademik, me mundësi rikonkurimi për aplikim, ndërsa obligimet e përfituesit/ës të bursës dhe kushtet e tjera, do të përcaktohen me kontratë.

V. PROCEDURA E PAGESËS

Neni 14

1. Mjetet financiare do të alokohen me 1 (një) ose 2 (dy) periudha të caktuara gjatë vitit fiskal në xhirologaritë bankare të përfituesve, në bankën të cilën studenti/ja e ka përzgjedhur.
2. Drejtoria kompetente për Financa dhe Drejtoria kompetente për Arsim janë të obliguara të kujdesen për alokimin dhe zotimin e mjeteve të cekura më lart, në afatin kohor.

VI. DISPOZIATA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Kjo rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

Neni 16

Në rast të zbrazëtirës juridike, do të vlejnjë drejtpërsëdrejti dispozitat pozitive ligjore dhe Udhëzimet tjera të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që rregullojnë çështjet e ndarjes së bursave për studente.

Neni 17

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjese për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqën zyrtare të komunës, kjo në kuptim të nenit 18 i Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/2013 dt.24.01.2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve komunale.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-2733/2016
Klinë, dt. 01/06/2016



KRYESUESI I KUVENDIT

Dr. Haxhi Ibishi